



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:060971

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01534292

P.nr.1004/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adnan Kamberi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.D. nga P., për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1596/20 të datës 28.05.2020, jashtë seancës me datë 24.02.2021, mori:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.1596/20 të datës 28.05.2020, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj, gjykata konform nenit 495 të KPPRK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

F. D., i biri i R. dhe R., e gjinisë F., i lindur me datë, në P., me vendbanim në Lagjen U.,, P., me nr. personal....., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 13.03.2020, rreth orës 19:39, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Prishtinë, më konkretisht në lokalitë ”A.”, pasi qw i pandehuri F. D. wshtw frustruar me blerjen e një makine thithëse sipas tij me defekt, të cilën e kishte blerë me datë 05.10.2019, ku të njejtën e ka kthyer në lokal, kurse në vend të asaj makine thithëse pa pëlqimin e punëtorëve, ka marrë një makinë thithëse elektrike tjetër të markës Conti me vlerë 74.99 Euro, duke vepruar në këtë mënyrë ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtat të cilat ka menduar se i takojnë, në vend se t'i drejtohet organit kompetent,

- Me këtë ka kryer veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, gjykata konform nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 410 par.1 të KPRK-së, si dhe neneve 365, 493 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës se prerë të këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK ndaj të njejtit dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'i kompensojë shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Pala e dëmtuar: për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1596/18 të datës 28.05.2020, kundër të pandehurit F. D. nga Prishtina, për veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykatës i është propozuar që kundër të pandehurit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me besueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPRK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi Penal me nr.ref.2020-AD-0854 i dt.01.04.2020; Procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit i dt.01.04.2020; Raporti fillestar i incidentit i dt.13.03.2020; Fletë raport zyrtar nga A. me nr.ID 51515; Procesverbal mbi intervistimin e Ankuesit e dt.13.03.2020; Raporti i oficerit J. B. i dt.13.03.2020, të gjitha këto janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për këtë edhe i shqiptoi urdhërin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të KPPRK.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 495 KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.1004/20; të datës 24.02.2021

G j y q t a r i
Adnan Kamberi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimet të tij, në këtë gjykatë.